



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VI  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 31/18  
Prishtinë, më 19.09.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**

Në mbledhjen morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontic, Ali Lajçi, Arbërie Nagavci, Mergim Lushtaku, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Lumir Abdixhiku, Dardan Molliqaj, Naser Osmani dhe Blerim Kuqi.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza- Ministër i Financave (MF), Lulzim Rafuna - Këshilltar i MF, Ismet Krasniqi – Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit të Kosovës, Valbona Bytyqi – nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Faruk Rrahmani nga ZKA, Petrit Gashi - Kryetar i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Bajram Zenjullahu – Anëtar Bordi në AKP, Avni Jashari – Zv. Drejtor në AKP.

Pjesëmarrës tjerë: Verona Bekteshi - Praktikante në KDI, Albulen Mavraj Gazetare në Epoka e Re, Valbona Bytyqi - Gazetare në Ekonomia Online.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli .

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj – Zëvendëskryetare e parë e komisionit (tutje: kryesuesja).

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 4, 18 dhe 25 korrik 2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjete Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq;**
- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale;**
- 5. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018;**
- 7. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017;**

- 8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe amendamenteve të komisionit funksional për Administrate Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media;**
- 9. Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesja:** Siç jeni njoftuar edhe përmes email-ia nga stafi mbështetës, propozojë që rendi i ditës të plotësohet edhe me dy pika: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjetës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI dhe shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës.

Kryesuesja konstatoi se komisioni unanimitisht vendosi plotësimin e rendit të ditës, me shtimin e dy pikave: Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjetës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI dhe Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës, si pikat 4 dhe 5.

### **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 4, 18 dhe 25 korrik 2018**

**Kryesuesja:** Konstatoi se Komisioni unanimitisht, miratoi procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 4, 18 dhe 25 korrik 2018, pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq**

**Kryesuesja** - Ministria e Financave ka nënshkuar marrëveshjen për hua prej 80 milion euro në mes të Republikës së Kosovës me Bankën Evropiane për investime për financimin e autostradës Prishtinë-Pejë dhe projekti do të zbatohet nga Ministria e Infrastrukturës. Është bërë analiza e ndikimit buxhetor në bazë të së cilës thuhet se mjetet janë pjesë e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Kushtet e kredisë janë të volitshme dhe për më tepër, ministri i financave do të na jep sqarime më të detalizuara për grejs periudhën, kur fillon dhe mbaron kthimi i kredisë, për normat e interesit ]ë aplikohen.

**Bedri Hamza** – Theksoi se autostrada Prishtinë-Pejë është një segment shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës, për uljen e kostos së biznesit në shkurtimin e kohës së qarkullimit. Marrëveshja për këtë projekt, parasheh një kredi prej 80 milion euro nga Banka Evropiane për Investime. Kushtet e kredisë janë më të favorshme se sa huamarrja në treg. Në po flasim për një marrëveshje kornizë dhe si rezultat kemi pranuar rregullat financiare të kësaj banke. Në bazë të marrëveshjes, Qeveria përmes Thesarit e bënë kërkesën për disbursimin e mjeteve, dhe pastaj caktohen kushtet e kredisë, çështja e grejs periudhës. Kjo bankë, nuk e ngarkon huamarrësin me tarifën e zotimit. Ky është një projekt madhorë do të implementohet vetëm kur Ministria kompetente e përfundon procesin e themelimit të Njësisë implementuese të projektit dhe angazhimin e stafit përkatës.

**Ali Lajqi:** Për këtë projekt kemi ratifikuar edhe një marrëveshje dhe është edhe pjesë e buxhetit vjetor. Pse nuk ka filluar zbatimi i tij?

**Bedri Hamza** – Unë jam shumë i lumtur të deklaroj se të gjitha projektet të cilat janë pjesë e buxhetit të Kosovës në vitin 2018 mund të realizohen në tërësi sa i përket aspektit të financimit të tyre. Sa i përket marrëveshjes financiare të nënshkruar me BERZH-in për këtë projekt, 71 milion euro janë në disponim për shfrytëzim dhe për ti tërhequr paratë duhet të respektohen procedurat e përcaktuara me marrëveshje. Mjetet ekzistojnë edhe janë të parapara edhe në buxhetin e Kosovës, por njësia përgjegjëse implementuese e projektit, duhet të lidhë kontratën e ekzekutimit sipas procedurave të përcaktuara me marrëveshje.

**Arbërie Nagavci:** Parashtrijë dy pyetje: E para është më shumë për sqarim, ju përmendet se kushtet e financimit për këtë projekt përcaktohen nga Banka Investive Evropiane dhe janë më të favorshme dhe po ashtu thatë se këto kushte, që ka të bëjë me interesin, grejs periudhën, caktohen pas disbursimit të mjeteve sipas kërkesës së Thesarit. Në këtë drejtim, a ka ndonjë normë interesit të minimumit dhe maksimumit apo të gjitha kushtet e kredisë do të përcaktohen më vonë, pas tërheqjes së mjeteve?

Çështja e dytë, ka të bëjë me rritjen e borxhi publik. Në këtë drejtim kemi pasur raste që kemi marrë vendime ad hoc në ratifikimin e marrëveshjeve, të shpejta dhe për projekte me një vlerë të madhe të financimit, ndërsa efikasiteti në realizimin e projekteve ka ngecur. Cili është qëndrimi i juaj si ministër i financave lidhur me rritjen e vazhdueshme të borxhit publik?

**Bedri Hamza:** Si ministër i financave jam mjaftë i kujdesëshëm për qëndrueshmërinë makro-fiskale. Por Kosova vazhdon ta ketë borxhin publik me të ultin në regjion, që aktualisht sillet rreth 16 % e buto produktit vendor (BPV). Nëse e shikojm periudhën e fundit kur une jam ministër i financave dhe periudhën paraprake, borxhi publik nuk ka shënuar ndonjë rritje e cila neve na banë për me u shqetësu, ndoshta si shumë ka shënuar rritje simbolike, por si përqindje me BPV-në e kemi stabilizuar sepse kemi pasur edhe rritje të BPV-së. Pra, sa i përket borxhit publik jemi brenda planifikimeve buxhetore dhe në përputhje me rregullën fiskale të deficitit buxhetore dhe borxhit publik. Jam në favor të asaj së për projektete të cilat kanë fizibilitet, përveç financimit nga buxheti i Kosovës me i shfrytëzu mundësitë alternative për financim dhe me kriju hapsirë brenda buxhetit të Kosovë dhe me u ba një prioritizim i prioriteteve tona. Nuk kam guxim me futë vendin borxh për projete të cilat nuk e kanë arsyeshmërinë e tyre.

Sa i përket kushteve të kredisë, aplikohen rregullat dhe standardet e Bankës Investive Evropiane (BIE) dhe siç thash kjo Bankë nuk aplikon tarifa të zotimeve, për dallim prej bankave dhe institucioneve tjera financiare, përfshirë edhe Bankën Botërore e kanë tarifën zotuese dhe nëse i zoton mjetete e nuk i shpenzon si huamarrës e pagun tarifën zotuese. Mbi bazën e analizave dhe vlerësimeve, BIE-ja është institucioni më i favorshëm për kredimarrja.

**Kryesuesja:** Theksoi se e kemi edhe një çështje, marrëveshjes i është bashkangjitur një dokument “studimi i fizibilitetit në kuadër të projeteve mbështetëse infrastrukturore të ballaknit perëndimor”, por këtë material e kemi vetëm në gjuhën angleze. A e keni të përkthyer këtë material në gjuhën shqipe e serbe sepse kur të publikohet në web faqe të Kuvendit duhet me qenë edhe në këto gjuhë.

**Bedri Hamza:** Theksoi se do të interesohemi në Zyën e Kryeministrit për këtë dokument në gjuhën shqipe dhe serbe, dhe nëse është i përkthyer do ta sjellim në Kuvend. Por nuk e di se a ka qenë ky dokument obligativ edhe në gjuhët tjera sepse është një dokument për kornizën e ballaknit perëndimor dhe ndoshta ka mundur të jetë dokument informues e jo obligues.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryesuesja konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

## **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr. 06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, për projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjetllës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI**

**Kryesuesja:** Theksoi se është një marrëveshja që ka të bëjë me financimin e programit për ujësjetllës dhe kanalizim në zonat rurale – faza e VI-të. Projekti do të zbatohet dhe kordinohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomike e cila do të fillojë të realizohet nga viti 2019. Nga buxheti i Republikës së Kosovës janë ndare 10,000,000 euro, ndërsa Qeveria e Zvicrës do të ndajë 3,362,180 euro. Ministria e Financave, e ka bërë vlerësimin e ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se ky Projektligj për t'u zbatuar ka kosto totale në vlerë prej 13,362,180 për vitet 2019-2021. Por, këtu e kemi një pyetje për sqarim: Ministria e Financave ka vlerësuar se shuma e grantit është 3,362,180 euro (për dallim prej shumës prej 7.1 milion franka zviceriane sa është shkruar në marrëveshje për vitet 2017-2021). Zvogëlimi i shumës së përlllogaritur nga Ministria e Financave, a është për shkak të kalimit të periudhës 2017-2018, siç është paraparë marrëveshja?

**Bedri Hamza:** Theksoi se marrëveshja në fjalë, ka për qëllim financimin e projekteve që përmirësojnë jetesën e qytetarëve. Në muajin korrik, Ministria e Financave ka nënshkruar marrëveshjen me Qeverinë e Zvicrës, e përfaqësuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim, dhe ka për qëllim vazhdimin e fazës së gjashtë të projektit të ujësjetllës dhe kanalizimit në zonat rurale të Kosovës. Deri më tani janë kryer me sukses pesë faza të këtij projekti dhe faza finale pritet të implementohet brenda tri viteve 2019-2021. Kjo është një marrëveshje me bashkëfinancim, ku si rezultat Qeveria e Zvicrës ofron grand prej 7.1 milion euro, ndërsa vlera e kontributeve të Qeverisë së Kosovës, përmes Ministrisë së Linjës për Zhvillim Ekonomik është 10 milion euro. Kjo shumë është përfshirë në KASH, nëpër vite si në vijim: 2019 janë 4 milion euro, 2020, 3 milion euro dhe 2021 janë 3 milion euro.

**Kryesuesja:** Theksoi se është identifikuar një lëshim teknik në projektligj: Ku në titullin e marrëveshjes përmendet “ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës”, ndërsa në tre nenet e Projektligjit, thuhet “ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës”. Me qëllim të harmonizimit të titullit të Projektligjit, sugjerojmë që të bëhet një amendament si në vijim:

Amendamenti 1 - Në nenin 1, nenin 2 dhe nenin 3, fjalët “Republikës së Kosovës”, ndryshohet me fjalët “Qeverisë së Republikës së Kosovës”

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryesuesja konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

## **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr. 06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjetllës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI, me amendamentin si vijon:

Amendamenti 1 - Në nenin 1, nenin 2 dhe nenin 3, teksti “Republikës së Kosovës”, ndryshohet me tekstin “Qeverisë së Republikës së Kosovës”.

## 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës

**Kryesuesja:** Projektligji ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes për Hua në shumë prej 20.7 milion euro, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës. Marrëveshja do të zbatohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe do të fillojë të realizohet nga viti 2019. Ministria e Financave, në analizën e vlerësimit të ndikimit buxhetor të marrëveshjes, ka vlerësuar se kostoja buxhetore 20,7 euro është pjesë e projeksioneve buxhetore të KASH-it 2019-2021. Kushtet e kredisë dhe normat e interesit janë të përcaktuara, po ashtu grejëse periudha, afati i fillimit dhe kthimit të kredisë.

**Bedri Hamza:** Marrëveshja është negociuar nga Ministria e Financave dhe ka për qëllim forcimin e kapitalit vendor dhe mbështetje të bizneseve për tu futur në ekonominë digjitale të Kosovës, krijimin e kushteve të përshtatshme përmes shtrirjes së infrastrukturës përkatëse të rrjeteve dhe mundësimi i shërbimeve brenda vendit. Po ashtu ky projekt do të ndikojë në përmirësimin e qasjes në tregjet ndërkombëtare dhe zhvillimin e modeleve të reja të biznesit. Përveç qasjes së tregjeve të punës mundësohet edhe qasja e burimeve globale e dijës përmes institucioneve arsimore edhe gjithashtu do të mundësohet edhe lidhja e rrjeteve të shërbimeve publike të zonave rurale. Marrëveshja në fjalë është kredi me vlerë prej 20.7 milion euro, me normë interes 0.84%, periudha e kthimit të kredisë është 30 vjet, duke përfshirë një periudhë prej 5 vjet grejëse periudhe.

**Mërgim Lushtaku:** Mua po me intereson me shumë se cili institucion do ta implementojë këtë marrëveshje, a është qeveria apo zbatimi i saj ndahet nëpër ministri apo organizata buxhetore?

**Bedri Hamza:** Sqaroi se implementues i këtij projekti do të jetë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, por ky lidhet edhe me Miistrinë e Arsimit, pasi që është projekt i fushës së arsimit.

**Arbërie Nagavci:** Theksoi se nuk viet në dyshim rëndësia e projekteve të digjitalizimit. Por për sqarim më intereson të dijë sa a janë të definuara saktë mjetet për të dy ministrinë, pasi që, kemi një rast të ngashëm ku Ministria e Arsimit pak vite më parë ka marr një projekte me kredi në lidhje me digjitalizimin e shkollave për 5 milion euro. A ka ndonjë analizë nga ministrinë e lartpërmendura dhe a ka diçka konkrete për rezultatet e pritura në këtë drejtim.

**Bedri Hamza:** Theksoi se bartëse e projektit është Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe ata e kanë projektin dhe nuk kishin mundur të finalizojnë negociatat pa pasur të kryer fizibilitetin e projektit. E kam thënë edhe në takim me ministrinë e përmendura, por edhe me organizatat tjera lokale e qendrore se ne kemi nevojë me i ngrit kapacitetet implementuese për zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe nuk është e pëlqyeshme që me e prit mjetet dhe projektet me ngec në ekzekutim ose me ardhë në atë situatë që si ministri e financave me i'u drejtu një institucioni financiar ndërkombëtar për me shty kohën e implementimit të projektit.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryesuesja konstatoi se Komisioni unanimit, nxori këtë

### **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës.

## 6. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale

**Kryesuesja** - Më këtë Projektligj është paraparë rishikimi i legjislacionit tatimor me qëllim të thjeshtëzimit të tij dhe mbështetjes së zhvillimit të sektorit privat përmes lehtësirave tatimore. Ky projektligj ndihmon drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në realizimin e Tatimit në të Ardhura Personale konform standardeve ndërkombëtare dhe rajonale.

Projektligji si i tillë përmban memorandumun shpjeguese për objektivat që synon ti realizoj ligji. Po ashtu projektligji përmban edhe opinionin për ndikimet buxhetore, që vlerësohet se Projektligji nuk do të ketë kosto buxhetore shtesë. Si dhe opinionin e Ministrisë së Integritetit Evropian për përputhshmërinë me Legjislacionin e BE-së, ku thuhet Projektligji për Tatimin në Ardhurat e Personale nuk është në kundërshtim me parimet bazë të legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë i plotëson të gjitha kushtet për tu proceduar në Kuvend në lexim të parë.

**Bedri Hamza:** Theksoi se Projektligji për tatimin në të ardhurat personale ka për qëllim të bëjë harmonizimin e mëtutjeshëm të këtij ligjit me legjislacionin në fuqi, harmonizimin me rekomandimet kombëtare, ndërkombëtare dhe thjeshtësimin e mëtutjeshëm të procedurave me ligjet tatimore në përgjithësi. Vlenë të theksohet se të gjitha institucionet e zbatimit të këtij ligjit kanë qenë të përfshira në procesin e hartimit të tij dhe janë bërë konsultimet me të gjithë aktorët dhe komentet relevante i kemi përfshirë në draft. Me këtë Projektligj kemi propozuar zbritjet e posaçme për pasurit e reja, periudhën e bartjes së shumës së humbjes, mbajtjet në burim në tatimin në paga dhe mbajtjen e kontributeve, është liruar nga bajtja në tatim në lirime pjesa e sigurimeve shëndetësore, është rregulluar tatimi i mbajtur në interese në të drejtat pronësore, janë qartësuar edhe për mbajtjen e tatimit për tarifën për udhëtimin jashtë vendit, dhe ajo që është me e rëndësishme janë thjeshtësuar shumë procedura të deklarimit të tatimit të të ardhurave personale.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryesuesja konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

### R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale.

## 7. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave

**Kryesuesja:** Theksoi se më këtë Projektligj është paraparë rishikimi i legjislacionit tatimor me qëllim të thjeshtëzimit të tij dhe mbështetjes së zhvillimit të sektorit privat përmes lehtësirave tatimore. Me këtë Projektligj janë bërë disa ndryshimet të cilat kanë efekt në sektorin privat. Si i tillë, Projektligji i plotëson kushtete formalo juridike për miratim në lexim të parë në Kuvend.

**Bedri Hamza:** Theksoi se edhe Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave është pjesë e reformës që ka për qëllim zhvillimin e sektorit privat. Pas analizave të bëra kemi konstatuar se zbatimi i legjislacionit të aplikueshëm për tatimin në të ardhurat e korporatave ka nevojë për azhurim si rezultat i zhvillimeve të fundit në legjislacionin e BE-së, por edhe me qëllim të përshtatjes së zhvillimit ekonomik dhe social të vendit tonë. Me këtë Projektligj avancohet mëtutje korniza ligjore si dhe eliminimi i zbrazësive aktuale ligjore dhe dispozitat jo të qarta dhe jo efektive. Me këtë Projektligj, ndër të tjera janë këto rregullime: periudha e bartjes së shumës së humbjes është zbritur prej 6 në 4 periudha të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme me zbritje për çfarëdo të ardhure, për fermerët,

grumbulluesit e materialeve recikluese, të frutave të malit dhe bimëve mjeksore dhe të ngjajshme me to obligimi i mbajtjes së tatimit është zvogëluar në 1% nga 3% sa ka qenë më herët.

Për kompanitë e sigurimeve është rregulluar që të taten njëjtë sikurse çdo person juridik, janë rregulluar nenet për humbjet e pritura nga kreditë edhe provizionimet matematike, të njëjtat janë shtuar si propozim në mënyrë që të jetë të qarta për tatimpaguesit dhe kjo është bërë që bankat të taten në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Sa i përket librave dhe regjistrimeve janë bërë hamronizimet me ligjin për tatimi mbi vlerën e shtuar nga 50,000 euro në 30,000 euro. Gjithashtu është ridraftuar paragrafi lidhur me lirimet tatimore dhe si rezultat do të përfillojnë të gjitha bizneset, të reja apo jo. Po ashtu është bërë një zbritje e posaçme për pasuritë e reja, është rregulluar transferi i çmimit, shmangia e tatimeve të dyfishta. Vlenë të theksohet se të gjitha institucionet dhe akterët relevantë kanë qenë të përfshira gjatë hartimit të këtij dhe rekomandimet relevante janë përfshirë në këtë projektligj.

**Arbërie Nagavci:** Theksoi se si grup parlamentar do ta japim kontributin në mes dy leximeve të projektligjit sepse i kemi disa çështje që i konsiderojmë të rëndësishme tek neni 16, 14, 18 e kështu me radhë. Në projektligj në mjaftë raste është paraparë nxjerrja e legjislacionit sekondar, derisa jemi dëshmitarë se ka mjaftë vonesa në nxjerrjen e tyre dhe si rezultat ka pasur edhe stangnim në implementimin e ligjeve, pikërisht për shkak të mungesës së legjislacionit sekondar. Pyetja ime është paraparë kaq shumë çështje të rregullohen me legjislacionin sekondar dhe nuk janë rregulluar me legjislacionin primar?

**Bedri Hamza:** Theksoi se shumë çështje janë lënë të rregullohen me akte nënligjore, edhe pse për ne si ministri e financave do të ishte më mirë dhe më e lehtë puna të precizoheshin çështjet me ligj, mirëpo disa çështje sipas praktikave rregullohen me akte nënligjore. Ajo që është e rëndësishme është afatizimi dhe nxjerrja e këtyre akteve nënligjore, që është propozuar brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit. Ne kemi propozuar që këto ligje të hynë në fuqi në fillim të vitit të ardhshëm, por kjo sigurisht varet nga dinamika e punës në Kuvend, edhe pse nuk jam i interesuar me e dëmtue cilësinë e tyre, për faktin se a hyjnë në fuqi dy muaj më herët apo pas. Mirëpo të miratojmë ligje të mira, dhe ti adresojmë sfidat dhe të krijojmë ambientë të mirë për biznese e sidomos për ndërmarrjet që kanë veprimtari prodhuese.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryesuesja konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

## **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr. 06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave.

### **8. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018**

**Kryesuesja:** Raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018 është hartuar bazuar në Ligjin e Buxhetit 2018 dhe rregullat financiare për raportim. Raporti përmban të dhëna për shpenzimet e Kuvendit në gjashtëmuorin e parë të këtij viti në total dhe sipas programeve: Deputetët e Kuvendit, Administrata e Kuvendit, dhe Stafit mbështetës politik, si dhe krahasimi i tyre me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Shpenzimet për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018, në total janë 4,432,890.68 euro. Janë pasqyruar edhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike. Lidhur me shpenzimet kapitale, po vazhdon trendi i njëjtë i shpenzimit të ulët të tyre të cilat për këtë periudhë janë shpenzuar

vetëm 1.56%. Po shihet se janë bërë disa punë në objekt që nuk po përfundojnë anjëherë. Prandaj, kërkojë nga sekretari të na njoftojë për shpenzimet kapitale, si ka rrjedhur dinamika e tyre, ku kemi ngecje dhe vështërisht në realizimin e tyre?

**Ismet Krasniqi:** Theksoi se në total buxheti i shpenzuar për periudhën raportuese 38.75%. Sipas kategorive, për paga dhe mëditje 48%, shërbime komunale 45%, subvencionet 50% dhe investimet kapitale janë 1.58%. Sa i përket shpenzimeve kapitale për shkak të ngecjes me procedurat e prokurimit dhe vonesës së lëndëve, kjo po ndikon edhe në dinamikën e realizimit të projekteve të planifikuara kapitale. Për shkak të procedurave të ligjit të prokurimit janë ankesa dhe pyetje sqaruese pyetje që janë duke na marrur kohën, por besoj dhe shpresojë deri në fund të vitit shpenzimet kapitale do të realizohen në nivelin e parashikimit.

**Arbërie Nagavci:** Pyeti, a ka mundësi që herave tjera, me e pas raportin edhe në menyrë elektronike raportin, pasi që raporti fizikisht përmban shumë shkronjat e vogëla dhe vështirë me i lexue.

**Enver Hoti:** Sa i përket investimeve kapitale, ju i dhatë sqarimet, por defekti po shkon i përsëritshëm që nuk është shenjë e mire kjo.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryesuesja konstatoi se Komisioni me Katër vota Për, Dy Abstenime dhe Asnjë Kundër, nxori këtë

### **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, të miratoj Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018.

## **9. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017**

**Kryesuesja** – Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar për AKP-në për vitin 2017. Në raport janë pasqyruar në mënyre analitike por edhe në mënyre të përmbledhur të gjitha shpenzimet për të gjitha kategoritë ekonomike. Raporti po ashtu përmban të dhënat për të hyrat që ka realizuar AKP-ja.

Në raportin janë pasqyruar buxheti fillestar, buxheti përfundimtar dhe shpenzimet. Në këtë raport gjithashtu janë paraqitur edhe krahasimet e shpenzimeve me vitin paraprak si dhe janë paraqitur se si kanë qene të planifikuara këto mjete. Po ashtu janë paraqitur edhe shpenzimet brenda kategorive dhe nënkategorive ekonomike.

Buxheti i AKP-së i aprovuar për vitin 2017 ka qenë 7,582,788€, të hyrat e dedikuara 6,920,884€, kurse Granti Qeveritar 661,904€. Në shumën totale është përfshirë edhe Granti Qeveritar prej 698,920 euro, të transferuar nga Qeveria e Kosovës për pagesën e OSHP-së për studimin e fizibilitetit për Trepçën. Po ashtu janë paraqitur edhe lëvizjet që janë bërë me rishikimin e buxhetit dhe është numri i të punësuarve.

Sa i përket numrit të të punësuarve në raport shihet që janë të planifikuar 258 punëtorë për të punësuar dhe janë punësuar 239, e në fund të vitit ky agjensione i ka pasur 20 punëtorë me pak, ndërsa buxheti i shpenzuarve këtë kategori të pagave dhe mëditjeve është 99.71%. Si i keni shpenzuar këto mjete, duke i pasur 20 punëtorë mangu? Po ashtu do të ishte më interes të jepen sqarime, për disa shpenzime si: Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit 856 euro, shërbimet e ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse 375,387 euro, shërbimet tjera kontraktueses 1,045,953 euro, furnizimet me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) 41,245 euro.

**Petrit Gashi:** Theksoi se kemi pasur një vit shumë të mirë brenda agjencisë në vitin 2017. Kemi pasur përparime të konsiderueshme në procesin e shitjes e huamarrjes së agjencisë për likuidim. Mirëpo janë



disa çështje që janë po e pengojnë në mas të madhe punën e agjencisë. Çështja e parë që është duke na brengosë është një vendim i vitit të kaluar i qeverisë për pezullimin e shitjes së tokave në pronësinë e ndërmarrjeve shoqërore dhe si rezultat na janë marrë një shumë e aseteve tona. Pas diskutimeve që kemi pasur me Qeverinë, kemi marrë përgjigjen se kjo çështje është e përkohshme dhe ka kaluar një kohë e gjatë dhe asgjë tjetër nuk është ndërmarrë në këtë drejtim. Si rezultat ne nuk jemi në gjendje që këto asete t'i vendosim në procesin e shtijes dhe kjo ka ndikuar edhe në ngecje të shumta në realizimin e planit për vitin 2018.

Çështja tjetër është një vendim i qeverisë për dhënien e pronave shoqërore për nevojat publike të komunave, të cilat nuk janë nën kontrollin tonë dhe konsiderojë se komisioni i juaj që është shumë i rëndësishëm sepse këtu është një barrë e konsiderueshme financiare. Sa i përket çështjes së pronësimeve nuk është problem vetëm i kësaj qeverie, por edhe qeveritë e mëhershme sipas përvojës për realizimin e projekteve infratrakturore, kanë shpronësuar prona të cilat janë pjesë e shpronësimeve dhe ne kemi punëtore apo kreditor që presin mjetet prej këtyre shpronësimeve. Një çështje e fundit që desha ta ngris është çështja e Dhomës së Veçantë që lidhet me transferimin e mandatit të EULEX-it. Kjo dhomë ka mbetur e paralizuar në tërësi sepse nuk mund të kompletohen pa staf të ri dhe kjo nuk mund të bëhet deri në aprovimin e ligjit të ri, që parasheh zëvendësimin e pozitave me gjykatës vendor pas transferimit nga gjykatësit e EULEX-it dhe kjo po ndikon edhe në punën e Agjencisë, respektivisht në procesin e ankimimit. Për të gjitha këto çështje kishim preferuar një mendim tuajin si komisioni se si të veprojmë.

**Kryesuesja:** Theksoi se ju ishte dashur t'ia dërgoni të gjitha paraprakisht informacionet dhe matricat për këtë çështjen e shpronësimeve dhe qeveria do të duhej ti marrë parasysh këto gjëra dhe mos të marrë vendime për shpronësimet ku ka kontrata të shitjes dhe ky problem duhet të zgjidhet mes juve dhe qeverisë. Ne si komision për buxhet dhe financa i shqyrtojmë vetëm raportet financiare dhe për çështje duhet diskutohet në komisionin për zhvillim ekonomik, që e shyrtojnë pjesën programore të punëve tuaj. Por, neve çfarë na takon do ti marrim me seriozitet çështjet e tilla. Por ne nuk i kemi informata për procesin e pronave dhe shpronësimeve, nuk ka ndonjë analizë për këtë proces, që ne si komision për me marrë një qëndrim apo rekomandim për këtë çështje.

**Petrit Gashi:** Theksoi se ne i kemi ndërmarrë krejt hapat që i parasheh ligji dhe ne i kemi ofruar të gjitha informatat e nevojshme për qeverinë, përpara se me ardhë të gjykimi por mendojë se janë vendimi të nxituara.

**Avni Jashari:** Theksoi se në faqen 9 të pasqyrave financiare është shënuar që numri i punëtoreve i aprovuare është 258, mirëpo ndarjet buxhetore që i bënë ministria e financave e marrin numrin e punëtoreve të cilët janë aktualisht. Sa i përket shpenzimeve për udhëtimet brenda vendit prej 856 eurove kjo ka qenë pjesë e shpenzimeve të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet me njërin prej ekspertëve që ka pasur për detyrë të përgaditjes së raportit të fizibilitetit të Trepçës dhe kjo ka qenë kërkesë e Qeverisë së Kosovës që akomodimin zyrtar t'i mbulojë agjencia, ndërsa pjesa tjetër ka është për shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse prej 375,000. Ndërsa në faqen e 14 bëhet fjalë për kompenzimin e anëtarit e komitetit të auditimit të jashtëm privatizimit dhe anëtarët e komisionit të jashtëm dhe anëtarët e bordit janë kompenzuar prej kësaj linje buxhetore. Sa i përket drektave zyrtare është një gabim teknik në leximin e raportit sepse në drektat zyrtare i kemi 6,200 euro e shuma 41,000 euro që e përmendet kryesuese është furnizimet për zyrë në vitin 2016.

**Valbon Bytyqi:** Njoftojë se për vitin 2017, Zyra Kombëtare e Auditimit ka bërë dy raporte për AKP-në: njërin për pasqyrat financiare dhe aktivitetet e saja e një tjetër e kemi bërë për fondet në mirëbesim. Sa i përket raportit për pasqyrat financiare ne kemi dhënë opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes. Theksim i çështjes është për shpenzimet për kompenzimin e bordit në shumë prej 375,000 euro që janë buxhetuar dhe paguar gabimisht nga kategoria mallrave dhe shërbimeve, derisa kategoria adekuate ishte

ajo e pagave dhe mëditjeve. AKP kishte një performancë të mirë buxhetore të realizuar prej 91% të buxhetit. Ne i kemi identifikuar edhe disa mangësi që kanë të bëjë me ushtrimin e pozitave me ushtries detyre, dobësimin në planifikimin të prokurimit ku disa prej tyre nuk kanë qenë të përfshira në planet e prokurimit, si dhe mosazhurimin e “E Pasurisë” për gjendjen e stokut ku ishte një diferencë prej 25,000 euro. Sa i përket raportit të auditimit të vitit 2016, kemi dhënë 10 rekomandime, prej tyre AKP i ka zbatuar 4 dhe 6 janë në proces të zbatimit.

Lidhur me raportin e fondit në mirëbesim, ne kemi dhënë një opinion të kualifikuar dhe ka të bëjë me pagesat e shërbimeve profesionale në vitin 2017 me vlerë prej 996,000 euro nga ky fond që është në kundërshtim me rregullat në fuqi. Pasi që kompesuesit e ofruesit të shërbimeve profesionale duhet të paguheshin nga mjete që i'u kishin nda agjencionit nga Buxheti i Republikës së Kosovës apo të siguruar nga ndonjë denator. Pagesa ishte bërë nga fondi i mirëbesimit, pasi që AKP nga buxheti i saj nuk kishte ndarë mjete për këtë pagesë. Agjencia kishte një performancë të kënaqshme dhe pas një periudhe dy vjeqare ka filluar edhe shitjen e aseteve të ndërmarrjeve buxhetore. Në këtë aspekt kemi identifikuar disa mangësi në proces dhe janë dy raste kur objektet e dhëna me qira janë shfrytëzuar nga qiramarrësit edhe pas skadimit të kontratës nuk ka bërë vazhdimin e përtrirjes dhe shpërndarja jo e plotë e 20% të ish punëtorëve të AKP-së. AKP është pajtuar me rekomandimet e dhëna dhe ka ofruar planin e veprimit për implementimin e tyre

**Ali Lajqi:** U folë për vendimet e Qeverisë për dhënien e disa aseteve për nevoja komunale, cilat janë ato edhe çfarë sektori, për zgjerim të administratës apo për toka bujqësore? Sa i përket raporteve të auditimit jo vetëm për këtë agjencion, por edhe për institucionet tjera, më shumë po kanë karakter të edukatës dhe këshillimit se sa në përmirësimin e gjendjes në sistemin e financave publike.

**Enverë Hoti:** Nëse e marrim si cilësi procesin e privatizimit nuk mund të konstatojmë se ky proces ka sjell zhvillim në vend dhe mirë është bërë që është pezulluar për momentin. Për çështjet që ngritët, përfshirë edhe shpronësimet e tokave për qëllime komunale është një çështje që duhet trajtuar, por duhet me na ofruar një listë shtesë me informata. Unë mendoj që shpronësimet janë në interes të zhvillimit të një projekti që është në interes të zhvillimit komunale. Sa i përket Dhomës së Veçantë, Projektligji është proceduar në parlament, por deputetët kanë hezituar për ta votuar. Sa i përket rekomandimeve të auditimit, sikurse në shumë organizata edhe tek ju janë vërejtjet me sistemin e prokurimit dhe me keqardhje po thëmë se ndoshta në të gjitha organizatat buxhetore, rekomandimet që i jep auditori po mbesin të pazbatueshme e kjo është për tu shqetësuar.

**Arbërie Nagavci:** Kam tre pyetje: E para më intereson të dijmë sa është numri i ofruesve dhe cili është dallimi me vitet e kaluara? E dyta, në raport është shënuar një pagesë për interes tek kategoria e shërbimeve kontraktuale dhe ju keni shkruar se pavarësisht që keni bërë kërkesë Ministrinë e Financave nuk iu është aprovuar kërkesa dhe jeni detyruar të bëni pagesën prej 10,583 euro për permbaruesit privat dhe si rrjedhojë është dëmtuar buxheti i Kosovës. A mund të më shpjegoni pse ministria e financave i'u ka refuzuar miratimin e kërkesës për pagesë, cilat janë arsyet? Pyetja e fundit, ka të bëjë me një shpenzim tek mallart dhe shërbimet që është prezentuar 25,157 euro ushqim dhe pije në kllapa për dreka zyrtare jozyrtare për çfarë ushqim dhe pije bëhet fjalë? dhe çfarë është furnizimi tjetër për veshëmbathje për punëtorë prej 8,000 euro?

**Petrit Gashi:** Sa i përket vendimeve të qeverisë për shpronësimin e tokave komunale ne në vazhdimësi kemi pranuar kërkesa prej komunave për shpronësimin e tokave për qëllime publike, si paracela për varreza, investime për zjarrëfikësit, shkolla e të ngjashme, por kemi pasur problem në realizimin e tyre për shkak të kufizimeve ligjore. Këto prona është dashur me u shpronësuar fillimisht dhe komunat nuk kanë hyrë në këtë proces për shkak të kufizimeve të tyre buxhetore dhe zakonisht kanë zgjedhur rrugën që qeveria ti bëjë shpronësimet e këtyre pronave. Tani kemi shumë prej këtyre pronave që janë shpronësuar me vendime të qeverisë dhe nuk jam shumë i sigurtë që janë përdorur të gjitha për qëllime

publike. Unë mendojë se është dashur një bashkëpunim më i ngusht në mes institucioneve kompetete në mënyrë që me i trajtue kërkesat e tilla brenda kornizës ligjore. Z. Lajçi i përmendi tokat bujqësore, por vendimi është shumë i paqartë.

Fatëkeqësisht nuk kemi një analizë se si e vlersojmë procesin e privatizimit se a ka pasur suksese. Por nëse nuk gaboj e kemi nda edhe një buxhet të vogël, por ende jemi në proces të realizimit. Sa i përket auditorit, menaxhmenti ka raportuar për planin e zbatimit të rekomandime ne bord dhe i kemi miratuar si ato të auditorit të brendshëm dhe ato të jashtëm dhe i kemi edhe mekanizmat mbikqyrës siç është komuniteti i auditimit që e ka përcjell zbatueshmërinë e tyre. Lidhur me pyetjen e znj. Nagavci lidhur me numrin e ofertuesve ne procesin e shitjes kemi numër më të madh në vitin 2017, kemi edhe rritje e vlerës së aseteve. Sa i përket çështjes së pagesave me vonesë kanë të bëjnë me studimin e fizibilitetit dhe vonesa është bërë për shkak të mos rishikimit të buxhetit gjatë tranzicionit prej qeverisë së kaluar në qeverinë e tashme edhe ne jemi penalizuar. Ne ju kemi drejtuar me disa letra edhe kontraktorit por nuk kemi mundur me e bind kontraktorin që të na lehtësojë procesin e pagesës.

**Avni Jashari:** Sqaroi se ofertuesit në vitin 2017 kanë qenë 1855 oferta në shumën totale prej 51 milion euro dhe janë nënshkruar 212 kontrata të privatizimit vetëm në vitin 2017. Për çështjen e pagesës për përmblyesit privat, Ministria e Financave, respektivisht departamenti i Thesarit i ka miratu dy pagesa per përmblyesit pa e njoftuar fare agjencinë dhe këto dy shuma kanë qenë njëra për Grupin Koha prej 1,400 euro, kurse tjera për Kompaninë e Sigurimit “Siguria” prej 1,180 euro. Pas kërkesës së AKP-së për kthimin e këtyre, grupi koha i ka kthyer mjetet sepse pagesat janë ekzekutuar por moskomunikim të duhur mes përmblyesit edhe grupit koha. Shuma e mjeteve prej kompanisë së sigurimeve jemi në komunikim dhe përkundër dëshmiave, nuk është kthyer shuma dhe nëse nuk i kthenë mjetet jemi të detyruar të nisim procedurën ligjore me padi në gjykatë. Sa i përket furnizimit me ushqim dhe pije të dhënat janë në faqën 10 dhe nuk bëhet fjalë për ushqim por për pije, kafe apo edhe furnizime tjera për takim me palët me jashtë. Shpenzimet për veshëmbathje kanë të bëjnë me mirëmbajtësit dhe për vozitësit zyrtar, për shkak të natyrës së punës të tyre.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryesuesja konstatoi se Komisioni me Tre vota Për, Tre Abstenime dhe Asnjë Kundër, nxori këtë

### **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të mos miratojë Raportin vjetor financiar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2017.

#### **10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe amendamenteve të komisionit funksional për Administrate Publike, Qeverisjen Lokale dhe Media**

**Kryesuesja:** Theksoi se në bazë të vlerësimit të ndikimit buxhetor të Ministrisë së Financave, shihet se Projektligji nuk përmban kosto shtesë buxhetore. Po ashtu as amendamentet e propozuara nga komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë. Me amendamentet e propozuara janë bërë edhe disa ndryshime sa i përket organizatave-OJQ me statut të përfituesit publik, ku janë hequr disa çështje që kanë të bëjnë me mundësinë e ushtrimit të aktiviteteve ekonomike të tyre, dhe është rregulluar çështja e pagesës së tatimeve të OJQ-ve me statut të përfituesit publik.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryesuesja konstatoi se Komisioni unanimit, nxori këtë

## **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për Projektligjin nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:45.**  
**Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

**Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit,**

-----  
**Safete Hadërgjonaj**